

## **Aktivite të muajit të hapur për periudhën 30 tetor deri në 3 nëntor**

### **KLSH mirëpret në Tiranë zhvillimin e një workshop në kuadër të grupeve të punës së EUROSAT-t**

Në kuadër të aktiviteteve të Muajit të Hapur në KLSH, në data 30 – 31 Tetor 2018 në Tiranë, Organizata Evropiane e Institucioneve Supreme të Auditimit, EUROSAT dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit zhvilluan workshopin mbi një prej drejtimeve kryesore të Planit Strategjik të EUROSAT-t 2017-2023, për mbështetjen e auditimeve efektive, inovative dhe adekuate përmes promovimit dhe ndërmjetësimit të bashkëpunimit profesional. Aktiviteti u organizua në kuadrin e Muajit të Hapur që KLSH e ka bërë tashmë traditë të performancës së tij prej disa vitesh. I themeluar në vitin 1990 EUROSAT ka si qëllim ndërtimin e një kuadri për shkëmbimin e njohurive midis Institucioneve Supreme të Auditimit Publik duke promovuar fuqizimin reciprok dhe përmirësimin e auditimit të fondeve publike. 50 SAT-t anëtarë formojnë një qark të larmishëm që përfaqëson Institucione Supreme të Auditimit (SAT ) me modele organizative, mandate, nevoja dhe prioritete të ndryshme.



SAT i Gjermanisë dhe SAT i Republikës së Çekisë drejtuan punimet dy ditore mbështetur në progresin e arritur nën këndvështrimin e aktiviteteve për të ardhmen. Prezantimet e SAT-ve të Lituanisë, Portugalisë, Estonisë dhe Polonisë ofruan një pamje të gjendjes dhe ecurisë të aktivitetit të Task Forcës mbi Bashkitë dhe Task Forcës për Etikën, po ashtu dhe të Grupit të Punës për auditimin e ambjentit dhe Grupit të Punës për Teknologjinë e Informacionit. KLSH u prezantua me një grup anëtarësh të stafit të drejtuar nga Drejtori i Përgjithshëm, Drejtore e Departamentit të Strategjisë dhe Metodologjisë, Drejtore e Drejtorisë së Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me jashtë dhe auditues të nivelit të lartë.

EUROSAT është një rrjet dinamik ku SAT-t dhe stafi i tyre mund të shkëmbejnë dijet në auditimin e sektorit publik, duke i aftësuar për t'iu përgjigjur kërkesave dhe rrethanave në ndryshim të vazhdueshëm. në objektivin që SAT-t të aftësohen për të krijuar me fleksibilitet auditime bashkëpunuese dhe t'i përgjigjen sfidave ekzistuese dhe atyre në zhvillim kur lind nevoja. Kontrolli i Lartë i Shtetit prezantoi vlerat dhe përfitimet nga eksperiencia e pjesëmarrjes në auditime paralele të organizuara nën ombrellën e EUROSAT-t. Megjithatë jo

të panjohura në spektrin teorik , vetëm pas vitit 2012 auditimet paralele morën zhvillim edhe në Shqipëri, duke ofruar rezultate pozitive si instrument efektiv për rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe përtej kufijve të një vendi. Pjesëmarrja në auditimet paralele me SAI të vendeve të rajonit por gjithnjë të mentoruara nga SAI të vendeve anëtare të BE , i ka ofruar KLSH mundësi unike të veprimtarisë audituese.

### **Prezantimi i Raportit të Buxhetit Faktik**

Për të bërë prezent mënyrën se si përgatitet nga KLSH Raporti për Zbatimin e Buxhetit të Shtetit nga Drejtori i Përgjithshëm znj.Manjola Naço dhe Drejtori i Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit, z.Azmi Stringa u prezantua në datën 30 tetor, në ambientet e institucionit raporti “Për Zbatimin e Buxhetit të Shtetit të vitit 2017”. Objektivi kryesor i gjithë punës audituese në funksion të përgatitjes së këtij Raporti është të evidentojë dhe analizojë problematikat në të tre komponentët e menaxhimit të sistemit buxhetor: programim, zbatim dhe monitorim, gërshetuar me vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm financiar publik si instrument bazë për garantimin e disiplinës fiskale.

KLSH, gjithashtu synon të tërheqë vëmendjen në problematikat e konstatuara lidhur me programimin, zbatimin dhe monitorimin e buxhetit, duke hedhur dritë mbi fakte që ndikojnë jo vetëm në performancën e buxhetit vjetor por ndikojnë dhe në të ardhmen e zhvillimit ekonomik, për të cilat kërkojmë vëmendjen maksimale.



Risi e këtij raportimi është se KLSH shprehet me opinionin e auditimit të zbatimit të buxhetit në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit të INTOSAI-t dhe në mënyrë specifike ka respektuar kërkesat e Standardit Ndërkombëtar të Auditimit të institucioneve supreme të auditimit (ISSAI) 1700: *“Formulimi i opinionit dhe Raportimit mbi pasqyrat financiare”*.



## **Prezantimi i Auditimeve më performante të performancës të 2-3 viteve të fundit**

Aktivitetet e datës 31 tetor vazhduan me prezantimin e tetë auditimeve më performante të 2-3 viteve të fundit të realizuara nga KLSH. Drejtori i Departamentit të Auditimit të performancës z.R.Muça bëri një përshkrim të shkurtër të fushave ku janë fokusuar auditimet e performancës dhe impakti i tyre në publik, media, Kuvend, shoqëri civile, bashkëpunime ndërkombëtare dhe eksperiencën departamentale.

Z.Muça përmendi se një qeverisje e mirë shprehet përmes një performance të mirë dhe vendet e zhvilluara përëndimore e kanë kthyer fokusin e tyre pikërisht tek auditimet e performancës. Gjithnjë duke e mbajtur vëmendjen tek shtimi dhe rritja e cilësisë së auditimeve, auditimet e performancës janë shndërruar në një nga shtyllat e zhvillimit dhe modernizimit të KLSH-së. Institucioni po përballë çdo ditë me një sfidë të fortë për ta përqendruar punën tek auditimi i performancës, sepse ai i shërben vlerësimit të përgjegjshmërisë publike, duke lidhur objektivat strategjike me fondet publike. Sfida më e madhe për këtë lloj auditimi është që ai mos të zbatohet thjesht si procedurë, por të konceptohet si një filozofi e të menduarit dhe vepruarit nga i gjithë stafi i KLSH-së. Një filozofi pune që konsideron se auditimi nuk është një qëllim në vetvete, por në radhë të parë një instrument parandalimi, instrument korrigjimi dhe këshillimi për institucionin që auditohet.

Zhvillimi i auditimeve është në linjë dhe në përputhje të plotë me objektivat e planit strategjik 2018-2022 të KLSH. Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2017 dhe gjysmës së parë të vitit 2018, u realizuan 16 auditime performance në reformat qeveritare, projektet dhe shërbimet social-ekonomike, projektet infrastrukturore, projektet mjedisore dhe energjitike, si dhe projektet dhe shërbimet social-kulturore.



Gjithashtu nga audituesit e Departamentit të Performancës u prezantuan auditimet me temë:

- Zhvillimi strategjik i turizmit nga znj.M Berdo
- Performanca e DAP – z.K Anastas
- Unifikimi i pikave doganore me Kosovën - z.S Agaj
- Strategjia antikorrupsion - znj.M. Kurushi
- Reforma administrative-territoriale - z.R Ametllari
- Kostimi i shërbimeve spitalore – z.A. Leskaj
- Performanca e arkivit të shtetit – z.D. Balliu


**Auditimet më të mira të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit**



Aktivitetet e datës 1 nëntor vazhduan me prezantimin e dy auditimeve më të mira nga Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit, të cilët u prezantuan nga Kryeaudituesit znj.V.Gaxha dhe z.K.Xhaferraj.

Auditimi i zhvilluar në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit në Ministrinë e Financave u prezantua nga Kryeaudituesi Znj.V.Gaxha, e cila theksoi se objektivi dhe qëllimi i auditimit ishte dhënia e një opinionimi mbi përputhshmërinë e aktivitetit të sistemit të thesarit me ligjin e buxhetit të shtetit dhe akte të tjera ligjore e nënligjore në funksion të realizimit të misionit dhe objektivit të kësaj drejtorie, si dhe bazueshmërinë me kërkesat e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Metodologjia e përdorur nga audituesit tanë në këtë auditim ishte vlerësimi i riskut, kombinimi i testeve thelbësore dhe testet e detajuara, gjetjet nga auditimet e mëparshme, auditimet paralele, identifikimi i sektorit kyc për qëllimin e auditimit dhe koha në dispozicion. Gjithashtu gjatë prezantimit u theksua cilët ishin aktorët dhe procesit se si funksionon Drejtoria e Thesarit në Ministrinë e Financave. Prezantimi shfaqti shumë interes tek audituesit, të cilët drejtuan pyetje për referuesit lidhur me metodën e analizimit dhe daljen në konkluzionin e auditimit.



Auditimi i zhvilluar në Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor u prezantua nga Kryeaudituesi z.K.Xhaferraj, i cili theksoi drejtimit kryesore të auditimit, gjetjet e auditimit, fushat ku janë konstatuar parregullsitë dhe problematikat e konstatuara. Z.Xhaferraj sqaroi se në këtë auditim janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në vendimmarrjet e organeve drejtuese të këtij institucioni, në menaxhimin e burimeve njerëzore, etj.

Temat u ndoqën me shumë interes nga audituesit e KLSH-së të cilët gjatë gjithë kohës drejtuan pyetje rreth auditimit, gjetjeve dhe konkluzioneve.

### **Prezantimi i tre auditimeve më të mira nga Departamenti i Auditimit të Pushtetit Vendor**

Në datën 3 nëntor, Kryeaudituesit Niko Nako, Lolita Baholli dhe Qemal Meta prezantuan përpara audituesve auditimet e zhvilluara nga ky departament për vitin 2018 dhe cili ka qënë fokusi i departamentit në këto auditime. Në tre auditimet e prezantuara fokusi i auditimit kanë qene shkeljet e akteve ligjore e nënligjore të mbledhjes së të ardhurave fiskale të cilat kanë shkaktuar dëm ekonomik buxhetit të shtetit. Një problematikë e ngritur në auditimet e kryera nga Departamenti i Auditimit të Pushtetit Vendor konstatohet se pasuritë e kaluara me VKM në pronësi të këtyre njësive vendore, ku në disa raste janë dhe të hipotekuara dhe të dhëna me qira nuk është bërë i mundur zbatimi i kushteve të kontratës duke lënë detyrimet kontraktore të pa arkëtuara dhe rritur nivelin e borxhit. Gjithashtu në shumicën e rasteve këto pasuri administrohen nga persona të tretë dhe nga njësitë vendore nuk është marrë asnjë masë për evidentimin e këtyre pronave dhe lidhjen e kontratave të qirasë, për të bërë të mundur realizimin e të ardhurave në favor të këtyre njësive. Nga auditimet e ushtruara nga KLSH, rezulton se në mjaft njësi të vetëqeverisjes vendore, është akumuluar një borxh i konsiderueshëm, nëpërmjet krijimit të faturave të palikuiduara ndër vite, për arsye te kryerjes së punimeve apo shërbimeve pa u siguruar më parë fondet e nevojshme për kryerjen e tyre.



Aktivitetet e Muajit të Hapur vijojnë dhe KLSH po vizitohet nga qyterë të interesuar, si edhe studentë të Universiteteve të ndryshme.